

Pyetja 1: Me thirrjen e parë publike, për veprimtarinë të cilën e veproj nuk kam mundësi për kreditim nga Banka Zhvillimore, kurse biznesi im është i prekur nga gjendja dhe dukshëm më janë ulur të ardhurat, jam jolukuid.

Përgjigje: Me thirrjen e parë publike për kreditim përmes Bankës Zhvillimore, për të cilën janë siguruar 5.7 milion euro për kredi pa interes, targetohen sektorët më të prekur, përkatësisht hotelieria, turizmi dhe transporti i mallrave. Në thirrjen e dytë publike për kreditim përmes Bankës Zhvillimore, e cila planifikohet të publikohet kah mesi i muajit prill, për të cilën janë siguruar edhe 8 milion euro shtesë, nuk do të ketë kufizime në sektorë/veprimtari, dhe ajo gjithashtu do të jetë kredi pa interes, e dedikuar për ndërmarrje të vogla, mikro dhe të mesme (mikrokreditim). Shuma e kredisë do të kushtëzohet nga numri i të punësuarve në kompaninë. Thirrja e dytë publike është në përgatitje dhe për të gjitha detajet rreth kësaj linje kreditore si dhe për publikimin e thirrjes publike do të njoftoheni publikisht dhe me kohë.

Pyetja 2: Kam aplikuar për kreditim përmes Bankës Zhvillimore në thirrjen e parë publike, por ende nuk ka përgjigje nëse më është aprovuar.

Përgjigje: Nga kërkesat (aplikimet) e përpunuara për kredi përmes thirrjes së parë publike, nënshkrimi i kontratave me 136 kompani aplikuese që plotësojnë kushtet është duke u zhvilluar. Banka Zhvillimore vazhdon të punojë intensivisht në përpunimin e kërkesave të mbetura në mënyrë që të përcaktojë plotësueshmërinë e kushteve dhe nënshkrimi i marrëveshje me kompanitë.

Pyetja 3: Kompania ime ka 260 të punësuar, por për shkak të situatës me virusin Korona, kompania ka problem të likuiditetit, punoj për eksport, ndërsa në periudhën e ardhshme dua të prezantoj një linjë të re prodhimi për pajisjet mjekësore. A ekziston mundësia për kreditim përmes Bankës Zhvillimore dhe me cilat kushte do të jetë kreditimi?

Përgjigje: Ajo që është duke u punuar aktualisht për tu vënë në dispozicion janë mjete nga 50.9 milion euro nga Banka Evropiane e Investimeve, ku Qeveria do të kyqet në subvencionimin e pjesës së harxhimeve të interesit. Me këtë masë, Banka Zhvillimore do të ofrojë një normë interesi dukshëm më të ulët për bankat tregtare, të cilat nga ana tjetër, do të jenë në gjendje të ofrojë kredi për përdoruesit përfundimtarë me normë interesi prej rreth 1.5%. Linja e kredisë do të jetë e dedikuar për të siguruar likuiditet në kapitalin aktual të punës së kompanive, si dhe për të siguruar kapital për të mbështetur projekte të reja, punësime të reja dhe rritje të eksportit. Grupe të synuara janë kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kushtet e funksionimit të së cilave duhet të lehtësohen, por mund të aplikojnë edhe ndërmarrjet deri në 1.000 punonjës.

Pyetja 4: Ka raste të punonjësve që frikësohen nga situata dhe mungojnë në mënyrë të pajustificueshme nga puna. Do t'ju kishim lutur të sqaroni Dekretin për subvencionimin e kontributeve, por dhe sqarim se si të veprojme me raste të tilla të punonjësve, sepse masat e Qeverisë për të parandaluar përhapjen e infeksionit nga njëra anë respektohen plotësisht, por ne me të vërtetë po luftojmë që procesi i punës të funksionojë pa ndërprerë me vëllim të shtuar të punës për shkak të situatës së shkaktar. Nëse marrëdhënia e tyre e punës përfundon pa një afat njoftimi, për të cilin kushtet janë plotësuar tërësisht, kompania vendoset në një pozitë të palakmueshme sepse nuk do të ketë të drejtën e subvencioneve, por e njëjta nuk parashikohet në Dekretin e subvencioneve. Kjo

do të thotë, sipas Dekretit për subvencionimin e 50% të kontributeve, kompania nuk do të ketë të drejtën e subvencioneve nëse nuk e mban të njëjtin numër të të punësuarve që nga 31.03.2020 (neni 4, paragrafi 2 pika b e Dekretit).

Përgjigje: Punëdhënësi që kërkon mbështetje financiare nuk duhet të zvogëlojë numrin e të punësuarve për muajin prill, maj dhe qershor 2020 në krahasim me numrin e të punësuarve deri më 31 mars 2020, duke i marrë parasysh edhe punonjësit përmes agjencisë private të punësimit, përveç në rastin e daljes në pension ose vdekjes. Në mënyrë plotësuese, theksojmë se pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe masave dhe rekomandimeve të miratuara nga Qeveria, punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës së punëtorit pa paralajmërim në rastet e shkeljes së rendit të punës dhe disiplinës, ose mospërmbushjes së detyrimeve të punës të përcaktuara nga ky ose ndonjë ligj tjetër, marrëveshja kolektive, rregullat për rendin dhe disiplinën e punës dhe kontratën e punës, veçanërisht nëse punonjësi mungon në mënyrë të pajustificueshme nga puna për tre ditë pune radhazi ose pesë ditë pune gjatë një viti.

Pyetja 5: Cilat janë kushtet për të marrë subvencion prej 50% nga kontributet për muajt prill, maj dhe qershor?

Përgjigje: Kompanitë që dëshirojnë të aplikojnë për të shfrytëzuar masën e subvencionimit 50% nga kontributet, duhet të plotësojnë kushtin që të ardhurat e tyre të janë zvogëluar për të paktën 30% në krahasim me mesataren e vitit 2019. Kushti i dytë është që numri i të punësuarve për muajt prill, maj dhe qershor 2020 të mos jetë më i vogël se numri i të punësuarve që nga 31.03.2020 dhe të mos paguajnë dividendë dhe shpërblime/bonuse nga dita e publikimit të dekretit deri në ditën e dorëzimit të llogarisë vjetore / raporteve financiare për vitin 2020. Nëse kompanitë janë të regjistruara vetëm disa muaj, merret mesatarja e periudhës në të cilën ata funksionojnë. Nëse ndërmarrja ka punë sezonale, merret mesatarja e tremujorit / sezonit që është i rëndësishëm nga viti i kaluar.

Pyetja 6: A mbështetja financiare për pagesën e pagës në vlerë prej 14.500 denarë i referohet pagës neto që punëdhënësi duhet të paguajë si pagën minimale neto, apo i referohet pagës bruto me vlerë prej 14.500 denarë?

Punëdhënësit do të marrin 14,500 denarë neto për punonjës në muaj dhe kjo nuk është pagë, por një shumë e mbështetjes financiare që çdo kompani mund ta përdorë.

Pyetja 7: Kur dhe si do të mund të aplikohet për mbështetje financiare për pagesën e pagave prej 14.500 për punonjës?

Përgjigje: Kompanitë mund të aplikojnë dhe ta përdorin masën për muajin prill në qoftë se e plotësojnë kriterin që kanë rënie të të ardhurave për 30% në krahasim me mesataren për vitin 2019. Kushti i dytë është të mos kenë paguar dividendë ose shpërblime/bonuse nga dita e publikimit të dekretit deri në ditën e shfrytëzimit të ndihmës, si dhe kushti i tretë është 10% e të punësuarve të mos kenë pagë mbi 120.000 denarë.

Nëse kompanitë janë të regjistruara vetëm për disa muaj, merret mesatarja e periudhës në të cilën ata funksionojnë. Nëse ndërmarrja ka punë sezonale, merret mesatarja e tremujorit / sezonit që është i rëndësishëm nga viti i kaluar.

Kompanitë mund të aplikojnë për të gjithë punëtorët të cilët kanë pagë neto deri në 39.900 denarë, për një vlerë deri në pagat një e gjysmë mujore.

Procesi i aplikimit për kompanitë realizohet përmes sistemit online E- Tatime të Drejtorisë së të Ardhurave Publike ku kompanitë dorëzojnë një kërkesë elektronike deri në datën 5 të muajit që ato i plotësojnë kriteret.

Përveç kësaj jepet një Deklaratë nën përgjegjësinë morale dhe penale që ka rënie të të ardhurave të kompanisë për më shumë se 30%. Në afat prej 3 ditëve, Drejtoria për të Ardhura Publike i informon kompanitë për atë se sa është e kompletuar kërkesa. Pastaj kompanitë në formularin LLMPI, të cilin e plotësojnë në nivel mujor për pagesën e pagave, shënojnë se për cilin punëtor kërkojnë ndihmë.

Në formularin shënojnë 619 vetëm nëse ata përdorin masat për pagë neto prej 14.500 denarësh dhe 621 nëse e përdorin masën – Subvencionim për rritje të pagave deri në 6.000 denarë. Pas aplikimit deri më datë 13- të të muajit çdo kompani do t'i ketë mjetet në llogarinë e saj.

Pasi që të arrijnë mjetet financiare në llogarinë e kompanisë, punëdhënësi është i detyruar më së voni deri më datën 15- të muajit t'i paguajë pagat e të punësuarve për të cilët ka aplikuar për masën për mbështetje financiare nga 14.500 denarë për pagesë të pagave.

Pyetja 8: Në cilin afat kohor duhet të dorëzohen llogaritjet për kontributet në pagë, në mënyrë që të përdorin masën? Nuk ka ndonjë përcaktim në Dekretin nëse mbetet deri më datën 5 të muajit aktual, për muajin e kaluar siç u njoftuan fillimisht në konferencën për shtyp. Gjithashtu, për nenin 9 të Dekretit, alineja e parë nuk përcakton nëse rezultati i punës nga viti 2020 duhet të jetë pozitiv apo negativ, përkatësisht a do të jetë fitim apo humbje, në mënyrë që ata ta dinë nëse do të duhet të kthejnë fondet përsëri në buxhet.

Përgjigje:Në lidhje me afatin e paraqitjes së formularit LLMPI për llogaritjen e pagës, në nenin 5 pika 5 të vetë Dekretit për masën për mbështetje financiare, thuhet se afatet e paraqitjes së formularit LLMPI në Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe pagesat e pagës, tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet sociale rregullohen në përputhje me ligjet ekzistuese për pagesë të pagave.

Sa i përket kthimit të mjeteve, neni 7 i Dekretit përcakton detyrimin për kthimin e tyre.

Punëdhënësi që ka shfrytëzuar të drejtën për mbështetje financiare për pagimin e pagave, ka detyrimin që mjetet e marra t'i kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por më së shumti deri në shumën prej 50% të rezultatit financiar të realizuar për vitin 2020 të rritur për shumën e shpenzimeve tatimore dhe me shënimin e më pak të ardhurave për bilancin tatimor për tatimpaguesit e tatimit të të ardhurave.

Punëdhënësi që ka rezultate negative të punës, ndërsa ka shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare, nuk ka asnjë detyrim të kthimit të mjeteve.

Pyetja 9: Unë jam një tatimpagues i taksës totale vjetore të të ardhurave. A mund të më shpjegoni pjesën për kthimin e parave të marra për mbështetje financiare për pagë, si 50% të rezultatit financiar të realizuar? Ju lutem më jepni shembuj që ta kuptoj? A duhet të kthej nëse kam humbje?

Përgjigje:

HUMBJE - Tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhuravei cili ka shfrytëzuar një masë të mbështetjes financiare në shumën 14.500 në muaj për çdo punonjës, mjetet e marra nga mjetet

financiare NUK do t'i kthejë nëse ai deklaron HUMBJEN si rezultat financiar në Bilancin e suksesit për vitin 2020.

FITIMI/ PROFITI - Tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhurave do të kthejë mbështetjen e aplikuar financiare, nëse ai deklaron FITIM si rezultat financiar në Bilancin e suksesit për vitin 2020, por e maksimizuar deri në shumën prej 50% FITIM para tatimit.

shembull:

1) Mbështetje financiare e marrë për 2 punëtorë

për muajt prill dhe maj 2020

$[(2 \times 14,500) \times 2] = 29,000 \times 2$

58,000

2) Fitimi para tatimit në Bilancin e suksesit

33.500

3) 50% e Fitimit para tatimit në Bilancin e suksesit

$(33,500 \times 50\%)$

16,750

4) Punëdhënësi, tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhurave

do të kthejë gjithsej

(në tre këste, 5,500 në muaj, në muajt

prill, maj dhe qershor 2021)

16.500

5) Shuma që punëdhënësi tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhurave

NUK do të kthejë

$(58,000 - 16,500)$

41,250

Varijant:

2) Fitimi para tatimit në Bilancin e suksesit

150,000

3) 50% e Fitimit para tatimit në Bilancin e suksesit

$(150,000 \times 50\%)$ 75,000

4) Punëdhënësi tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhurave

do të kthente shumën totale të mbështetjes financiare të pranuar (në tre këste, 19,333 në muaj, në muajt prill, maj dhe qershor 2021) 58,000

Rregull:

Shumën totale të mbështetjes financiare të pranuar do ta kthente VETEM ai punëdhënës, tatimpaguesi i taksës totale vjetore të të ardhurave cili para tatimit do të realizonte FITIM DYPISH më të lartë se mbështetja financiare e pranuar (58,000 x 2)

116,000

Pyetja 10.1.: Unë jam një tatimpagues i tatimit të fitimit. A mund të më shpjegoni pjesën për kthimin e parave të marra për mbështetjen financiare për pagë, si 50% të rezultatit financiar të realizuar? Ju lutem më jepni shembuj për ta kuptuar? A duhet të kthej nëse kam humbje?

Përgjigje:

HUMBJE (BAZË TATIMORE = ZERO)

Një tatimpagues i fitimit që ka shfrytëzuar masë të mbështetjes financiare në shumën 14.500 për punonjës në muaj NUK do t'i kthejë mjetet financiare nëse ai ka deklaruar HUMBJE si rezultat financiar në Bilancin e suksesit në vitin 2020, që është më i lartë se shpenzimet e tatimeve në Bilancin e tatimeve.

Ky tatimpagues nuk ka formuar një bazë tatimore për tatimin e fitimit të AOP 40 nga Bilanci i tatimit për tatimin e fitim - formular TF për vitin 2020.

FITIM (BAZË E FORMUAR TATIMORE)

Shënim: REZULTATI FINANCIAR (FITIM ose HUMBJE para tatimit)

+ Shpenzimet tatimore formojnë BAZËN TATIMORE për tatimin e fitimit

Mbështetjen financiare të pranuar, tatimpaguesi i taksës së fitimit do ta kthejë nëse ai deklaron BAZË TATIMORE në Bilancin e Tatimit për vitin 2020 (AOP 40), por maksimumi duhet të jetë deri në shumën 50% nga BAZA TATIMORE.

Shembull:

1) Mbështetje financiare e marrë për 5 punonjës

për muajt prill dhe maj 2020

$[(5 \times 14.500) \times 2] = 72.500 \times 2$

245,000

2) Baza tatimore në Bilancin e Tatimit për vitin 2020

68,000

3) 50% e bazës tatimore në Bilancin e Tatimit për vitin 2020

34,000

(68,000 x 50%)

4) Punëdhënësi, tatimpaguesi i tatimit të fitimit

17,000

do të kthejë gjithsej

(në tre këste, me 5.667 në muaj, në muajt

prill, maj dhe qershor 2021)

5) Shuma që punëdhënësi, tatimpaguesi i tatimit të

fitimit NUK do ta kthejë

(245,000 - 17,000)

228,000

Varijanti:

2) Baza tatimore në Bilancin e Tatimit për vitin 2020

950,000

3) 50% të bazës tatimore në Bilancin e Tatimit për vitin 2020

(950,000 x 50%)

475,000

4) Punëdhënësi, tatimpaguesi i tatimit të fitimit

do të kthente shumën totale të mbështetjes financiare të pranuar

(në tre këste, me 81,667 në muaj, në muajt

prill, maj dhe qershor 2021)

245,000

Rregull:

Shumën totale të mbështetjes financiare do të kthejë VETEM ai punëdhënësi, tatimpaguesi i taksës së tatimit i cili do të deklarojë BAZË TATIMORE për taksën e fitimit - DYFISH më të lartë se mbështetja financiare e pranuar (245,000 x 2) 490,000

Pyetja 10.2: Zejtari - kryerës i pavarur i veprimtarisë, si mund të aplikojë për masën e pagës prej 14.500 denarë për muajin prill dhe maj?

Përgjigje: Një person i cili kryen një zanat - kërkues i mbështetjes financiare paraqet Kërkesë për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare pranë Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Forma

dhe përmbajtja e kërkesës për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare përcaktohet nga ministri i Financave.

Kërkesa paraqitet përmes sistemit të e- taksave të Drejtorisë së të Ardhurave Publike deri më datën 5 të muajit aktual, për muajin e kaluar, dhe kompletimi i kërkesës konfirmohet nga Drejtoria e të Ardhurave Publike, brenda 3 ditëve nga dita e pranimin të kërkesës.

Në Kërkesën, personi fizik që kryen një veprimtari të pavarur, jep një Deklaratë për përmbushjen e kushteve të Dekretit.

Drejtorja e të Ardhurave Publike e informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për personat fizike që kryejnë veprimtari të pavarur- kërkues të mbështetjes financiare të cilët kanë përmbushur kushtet për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare.

Shuma e mbështetjes financiare paguhet deri më datë 13 të muajit aktual për muajin e kaluar përmes programit të Qeverisë për mbështetje financiare për personat fizike që kryejnë veprimtari të pavarura.

Pyetja 11: Si mund të aplikojë një kryerës i pavarur i një veprimtarie për masën e pagës 14,500 denarë për muajin prill dhe maj?

Përgjigje: Procedura është e njëjtë si për pyetjen e paraprake në lidhje me Personat që kryejnë veprimtari artizanale, të cilat përfshihen në të njëjtin Dekret.

Një person i cili kryen një veprimtari - kërkues i mbështetjes financiare paraqet Kërkesë për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare pranë Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare përcaktohet nga ministri i Financave.

Kërkesa paraqitet përmes sistemit të e- taksave të Drejtorisë së të Ardhurave Publike deri më datën 5 të muajit aktual për muajin e kaluar, dhe kompletimi i kërkesës konfirmohet nga Drejtoria e të Ardhurave Publike, brenda 3 ditëve nga dita e pranimin të kërkesës.

Në Kërkesën, personi fizik që kryen një veprimtari të pavarur, jep një Deklaratë për përmbushjen e kushteve të Dekretit.

Drejtorja e të Ardhurave Publike e informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për personat fizike që kryejnë veprimtari të pavarur- kërkues të mbështetjes financiare të cilët kanë përmbushur kushtet për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare.

Shuma e mbështetjes financiare paguhet deri më datë 13 të muajit aktual për muajin e kaluar përmes programit të Qeverisë për mbështetje financiare për personat fizike që kryejnë veprimtari të pavarura.

Pyetja 12: Ne jemi të paraqitur si të papunësuar, nuk kemi të ardhura, si mund ta arrijmë deri masa e Qeverisë për ato 7,000 denarë?

Përgjigje: Nëse jeni një amviseri materialisht e pasiguar, ju lutemi kontaktoni Qendrën për Mbrojtje Sociale të bashkësisë lokale kompetente, në mënyrë që të mund të paraqisni të drejtën për të marrë asistencë minimale të garantuar, si dhe një të drejtë tjetër nëse ju takon në pajtim me Ligjin për Mbrojtje Sociale dhe Ligjin për Mbrojtje të fëmijëve.

[\(Link PMM\)](#)

Pyetja 13: Kam pasur kontratë me kohë të pacaktuar, por për shkak të tërë situatës, pronari im më pushoi nga puna. A mund të përdor ndonjë nga masat e Qeverisë?

Përgjigje: Nëse keni ndërprerje të marrëdhënies së punës, mund të përdorni kompensim monetar. Një person i papunë që ka qenë i punësuar për të paktën 9 muaj vazhdimisht, ose 12 muaj me pushim në 18 muajt e fundit, ka të drejtën e kompensimit monetar para përfundimit të punësimit. Kompensimi monetar paguhet sipas viteve të përvojës së punës. Informacion më të detajuar në lidhje me të drejtën e keni në linkun në vijim: [https://av.gov.mk/paricen-nadomestok.nspix\(kompensim monetar\)](https://av.gov.mk/paricen-nadomestok.nspix(kompensim%20monetar))

Pyetja 14: Një person i papunë që humbi punën për shkak të krizës nga Korona, cilat të drejta mund t'i realizojë?

Përgjigje:

Kompensimi monetar për qytetarët që humbën vendin e punës për shkak të krizës, në përputhje me përvojën/ kohëzgjatjen e punës, që realizohet përmes Agjencisë së Punësimit.

[https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki/merka-4\(masa/masa-ekonomike/masa-4\)](https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki/merka-4(masa/masa-ekonomike/masa-4))

Kompensimi monetar përmes sistemit të mbrojtjes sociale, i cili realizohet përmes qendrës kompetente për punë sociale (ndihma minimale e garantuar, shtesa të energjisë dhe shtesa arsimore)

[https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki/merka-7\(masa/masa-ekonomike/masa-7\)](https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki/merka-7(masa/masa-ekonomike/masa-7))

Gjithashtu, nëse konsideroni se të drejtat tuaja të punës janë të prekura ose janë shkelur, ne ju udhëzojmë të drejtoheni në Inspektoratin Shtetëror të Punës.

PARAQITJE nga një aplikant i njohur (person fizik)

http://dit.gov.mk/?page_id=208

PARAQITJE nga një aplikant anonim

http://dit.gov.mk/?page_id=202

poplaki@dit.gov.mk; 3296-310; 3116-110

Pyetja 15: Një punëdhënës i jep një punonjësi pagë minimale për muajin prill dhe maj, ndërsa personi juridik i kushtëzon ata të nënshkruajnë që nuk do të punojnë pas muajit maj.

Përgjigje: Për çdo shkelje të të drejtave të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, punonjësit duhet të raportojnë pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës.

PARAQITJE nga një aplikant i njohur (person fizik)

http://dit.gov.mk/?page_id=208

PARAQITJE nga një aplikant anonim

http://dit.gov.mk/?page_id=202

poplaki@dit.gov.mk; 3296-310; 3116-110

Pyetja 16: Ku mund të marrim leje për lëvizje gjatë orës policore?

Përgjigje: Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës jep leje për lëvizje gjatë orës policore për punonjësit e organeve të pushtetit shtetëror, shtabeve të krizës, mediave, ndërmarrjeve të varrimit dhe furrat deri në 5 punonjës.

Të gjitha informacionet se si të merrni leje mund t'i gjeni në linkun në vijim:
<http://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/2875>

Për sektorin privat, formulari plotësohet nga vetë kompania dhe duhet të jetë e verifikuar nga ata. Të gjitha informacionet mund t'i gjeni në linkun në vijim:
<http://www.mchamber.org.mk/default.aspx?mId=96&htmlid=846&lng=1>

Pyetja 17: Ku mund të marrim leje për lëvizje gjatë orës policore për person që është në përkujdesje, përkatësisht për një person që përkujdeset për persona të tjerë?

Përgjigje:

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

Informacion për të gjitha lejet përmes MSHIA

<http://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/2908>

Të gjitha lejet e dhëna nga MSHIA janë në dispozicion përmes portalit uslugi.gov.mk

Video link me informacione për atë se si të merret leja!

<https://www.youtube.com/watch?v=Va028SR6y7s&feature=youtu.be>

Për t'iu drejtuar MSHIA-së për ndonjë problem

cabinet@mioa.gov.mk

Pyetja 18: Unë kam prindin që ka nevojë për kujdes nga një person tjetër, më saktësisht nëna ime vuan nga demenca dhe ka nevojë për praninë time atje. Duke pasur parasysh ndalimin e lëvizjes, si mund të marr një leje ose çfarëdo që të duhet për të mundur të shkoj dhe të kthehem?

Përgjigje: Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës jep leje për lëvizjen e personave që janë ofrues të përkujdesit ndaj personave të tretë, vetëm në bazë të dokumentacionit të plotë mjekësor të dorëzuar.

Pyetja 19: A mund të lëvizin punonjësit e ndërmarrjeve ndërtimore për nevoja të punës gjatë orës policore?

Përgjigje: Ndërtimtaria është një nga sektorët kryesorë -përkrah prodhimit, për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe pikërisht për këtë arsye aktivitetet e filluara të ndërtimit nuk duhet të ndalen në këtë periudhë.

Lejet për lëvizjen e punëtorëve gjatë orës policore mund të përdoren gjithashtu për ndërtuesit, duke pasur parasysh faktin se vendi i tyre i punës është në objekt dhe mund të trajtohet si prodhim.

Lejet për lëvizjen e punëtorëve gjatë orës policore jepen nga vetë punëdhënësi, në një memorandum të kompanisë, ndërsa sipas modelit të miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Koordinimit me Krizat, më 22 mars 2020, i dorëzuar në të gjitha odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve dhe shoqatat e tjera.

Përveç verifikimit në vetë kompaninë, leja e lëvizjes për një punëtor që punon nuk duhet të verifikohet nga një organ tjetër të administratës shtetërore. Punëtori për të cilin është dhënë një leje e përshtatshme për të lëvizur në orë policore, duhet ta bartë me vete lejen për të lëvizur gjatë orës policore ndërsa lëviz nga vendbanimi i tij në vendin ku ai kryen detyra pune dhe anasjelltas, dhe në rast të kontrollit nga një anëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme / policisë, duhet ta tregojë atë.

Sipas Ligjit për marrëdhënie pune, punëdhënësi organizon procesin e punës sipas nevojave dhe kushteve, sa i përket punës jashtë orarit, me ndryshime ose natën, nëse është e nevojshme, e njëjta mund të realizohet, kështu që duhet të respektohet Ligji për marrëdhënie pune, dispozitat e të cilit janë gjithashtu të vlefshme gjatë një gjendje të jashtëzakonshme, përveç nëse me dispozitë parashikohet ndryshe.

Pyetja 20: Pushimi i lehonisë më mbaroi në 20 Mars. Nuk kam askënd që mund të kujdeset për fëmijën tim, edhe bashkëshorti poashtu është i punësuar. Çka me ne?

Përgjigje: Është miratuar Dekreti për vazhdimin e pushimit të lehonisë, dhe i përfshin ato prindër, leja e lehonisë së të cilëve skadon nga dita e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme (18.03.2020) deri në ditën e përfundimit të masave të përkohshme. Ju lutemi drejtohuni te Fondi për Sigurim Shëndetësor për të rregulluar vazhdimin, si institucion kompetent për këtë çështje.

Pyetja 21: A mund të ma shpjegoni pjesën e përdorimit të pushimit vjetor? Nëse kemi shumë punë dhe punonjësi kërkon një pushim që ne nuk mund t'ia japim atij për momentin, a kemi të drejtë ta bëjmë atë?

Përgjigje: Me Dekretin për zbatimin e Ligjit për marrëdhënie pune gjatë gjendjes së jashtëzakonshme rregullohet përdorimi i pushimeve vjetore të punonjësve në sektorin privat.

Për punonjësit e punësuar në sektorin privat të përfshirë nga masat e përkohshme për mbrojtje nga përhapja dhe parandalimi i virusit Korona COVID-19, pjesa e pashfrytëzuar e pushimit vjetor, përkatësisht pushimit të pashfrytëzuar vjetor, nga viti kalendarik 2019, të shfrytëzohet deri më 31 maj 2020, në pajtim me nevojat e procesit të punës dhe aprovimin e punëdhënësit.

Për punëtorët në sektorin privat të përfshirë me masat e përkohshme për mbrojtje nga përhapja dhe parandalimi i virusit Korona COVID-19, pjesa e pushimit vjetor për vitin 2020 që duhet të shfrytëzohet për dy javë të pandërprera pune, ta shfrytëzojnë deri në 30 qershor 2020, në pajtim me nevojat e procesit të punës dhe aprovimin e punëdhënësit.

Punëdhënësi ka të drejtë të japë ose mos japë pushim vjetor në pajtim me nevojat e procesit të punës.

Pyetja 22: Unë jam e punësuar në sektorin privat, pasi që jam e shtatzënë përdor masën për lirim nga puna. A ka të drejtë punëdhënësi të më ulë pagën? Detyrat e punës i bëj nga shtëpia.

Përgjigje: Sipas konkluzave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, masat dhe rekomandimet për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së virusit Korona COVID 19, vlejné si për

sektorin publik ashtu edhe për atë privat dhe mungesa nga puna duhet të konsiderohet si mungesë e arsyeshme.

Pyetja 23: A duhet të marrim vërtetime të reja nga kopshtet / shkollat në që tashmë kemi marrë leje më parë për lirin e një prindi nga puna?

Përgjigje: Vërtetimet e njëjta vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në skadimin e masave të përkohshme.

Pyetja 24: A mundet që bashkëshorti im dhe unë ta shfrytëzojmë masën e lirit të një prindi të një fëmije deri në moshën 10 vjeç, përkatësisht një javë ta shfrytëzojë bashkëshorti e një javë unë?

Përgjigje: Masa mund të përdoret nga të dy prindërit. Përveç deklaratës personale me shkrim të cilën e dorëzoni pranë sektorit të burimeve njerëzore, pas përfundimit të masave të përkohshme, duhet të dorëzoni edhe një vërtetim përkatës nga kopshtet / shkollat për periudhat që prindërit kanë shfrytëzuar masën.

Pyetja 25: A është e mundur që, përderisa përdor masën e lirit nga puna, pasi që jam person me sëmundje kronike, punëdhënësi të kërkojë të kthehem në punë?

Përgjigje: Në pajtim me masat dhe rekomandimet e Qeverisë së RSM –së për mbrojtjen dhe parandalimin e virusit Korona COVID 19, personat me sëmundje kronike me vërtetim nga mjeku amzë janë të liruar nga puna. Megjithatë, në deklaratën personale me shkrim të cilën e dorëzoni bashkangjitur me vërtetimin, thotë se jeni në dispozicion të punëdhënësit dhe nëse është e nevojshme ai mund t'ju kërkojë të paraqiteni në punë për 2 ose 3 orë.